

Pyetje të shpeshta

Përmbledhja e Programit NYC Test & Trace

Çfarë është NYC Test & Trace Corps?

Një nismë e shëndetit publik që lufton kundër COVID-19. Përmes burimeve dhe veprimeve FALAS, NYC Test & Trace Corps synon të frenojë shpërthimin e COVID-19 dhe të mbrojë qytetin tonë. NYC Test & Trace Corps, i cili hyri në qarkullim më 1 qershor 2020, është një grup mjekësh, profesionistësh të shëndetit publik dhe qytetarë të Nju Jorkut që punojnë për të luftuar kundër COVID-19 në mënyrë që të gjithë të mund të kthehemi në shkollë, punë dhe të ndihmojmë ta mbajmë qytetin e Nju Jorkut tëshëndetshëm dhe të sigurt.

Corps drejtohet nga qyteti i Nju-Jorkut përmes NYC Health + Hospitals në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Shëndetësisë të qytetit të Nju-Jorkut (Department of Health and Mental Hygiene) dhe agjenci të tjera të qytetit.

Çfarë qëllimi ka Test & Trace Corps?

Corps synon t'i mbajë të gjithë njujorkezët të sigurt duke reduktuar përhapjen e virusit dhe duke garantuar që ata me sëmundje të konfirmuar COVID-19 të kenë mundësi të veçojnë dhe mbrojnë njerëzit e tyre të dashur. Puna e Corps bazohet mbi tri parime:

Testimi

Testimikonfidencial dhe i sigurt për COVID-19 u ofrohet pa kosto të gjithë njujorkezëve në qindra pika testimi në të gjithë qytetin.

Gjurmimi

Qëllimi i gjurmimit është identifikimi i personave që mund të jenë ekspozuar ndaj sëmundjes përmes kontaktit të ngushtë dhe t'i ndihmojë ata në gjetjen e vendit më të mirë për t'i veçuar në mënyrë të sigurt nga të tjerët. Me ndihmën e mijëra profesionistëve të trajnuar të shëndetit publik që quhen gjurmues të kontakteve, kjo përpjekje do t'u ofrojë mbështetje njujorkezëve që rezultojnë pozitiv me COVID-19.

Përkujdesja

Gjurmuesit e kontakteve do të sigurohen që gjithkush që rezulton pozitiv me COVID-19 dhe personat e tyre të ngushtë të kontaktit të kenë burimet e nevojshme për t'u veçuar në mënyrë të sigurt në shtëpi apo në një hotel, pa pagesë. Hotelet do të kenë monitorim në çdo orë të ditës nga infermiere dhe personel i trajnuar klinik, me të gjitha vaktet të përfshira, mundësi mbështetjeje për shëndetin mendor dhe mirëqenien, si dhe telefonata të pakufizuara lokale falas për të ruajtur lidhjet me njerëzit e dashur. Për njujorkezët që zgjedhin të veçohen në mënyrë të sigurt në shtëpi, ekipi i Përkujdesjes do t'i ndihmojë me ushqim dhe shpërndarjen e mjekimeve.

Kë duhet të telefonoj nëse kam pyetje rreth NYC Test & Trace Corps ose COVID-19?

Për pyetjet rreth COVID-19, informacionit të pikës së testimit, gjurmimit të kontakteve dhe burimeve për të mbrojtur veten dhe të dashurit tuaj, telefononi 212-COVID19 (212-268-4319). Kemi operatorë të disponueshëm për t'ju dhënë përgjigje pyetjeve tuaja çdo ditë nga ora 09:00 - 21:00.

Si do ta garantojë NYC Test & Trace Corps privatësinë dhe sigurinë e informacionit personal?

NYC Test & Trace Corps është i përkushtuar të mbrojë privatësinë dhe sigurinë e informacionit të shëndetit personal të njujorkezëve siç kërkohet nga ligji federal, shtetëror dhe lokal, si dhe të ruajë përvojën afatgjatë të NYC Health + Hospitals dhe Departamentit të Shëndetësisë të qytetit të Nju Jorkut me ruajtjen e një informacioni të tillë. Informacioni që NYC Test & Trace Corps merr përmes gjurmimit të kontakteve është konfidencial dhe mbrohet sipas Kodit Shëndetësor të qytetit të Nju Jorkut.

NYC Test & Trace Corps nuk do të pyesë për statusin e imigrimit të askujt. Baza e të dhënave të Corps nuk do të lidhet me asnjë bazë të dhënash mbi zbatimin e ligjit. Çdo informacion që merr NYC Test & Trace Corps do të ruhet në mënyrë të sigurt dhe do të përdoret nga stafi i autorizuar për qëllimin e kufizuar të mbrojtjes së shëndetit publik.

A do të konsiderohet kush “barrë publike” sipas ligjit të imigracionit për marrjen e shërbimeve nga Test & Trace Corps?

Jo. Testimi, biseda me një gjurmues kontaktesh ose përdorimi i një nga hotelet Take Care për të veçuar në mënyrë të sigurt nuk do të cenojë mundësinë tuaj për të aplikuar për qëndrim të përhershëm (kartë jeshile). Për më tej, trajtimi mjekësor apo shërbimet e kujdesit shëndetësor parandalues në lidhje me COVID-19 NUK do të preken nga rregulli i barrës publike.

Si po punon NYC Test & Trace Corps për të kuptuar nevojat e ndryshme të njujorkezëve, veçanërisht të komuniteteve që janë më të prekurit nga virusi?

NYC Test & Trace Corps po punon për të garantuar që kjo përpjekje që kjo përpjekje të reflektojë qytetin e larmishëm të cilit i shërben. Grupet e komunitetit ofrojnë këshilla dhe mbështetje për të na ndihmuar të japim shërbime efikase, të përshtatshme nga ana kulturore dhe për të adresuar nevojat e komuniteteve që janë prekur në mënyrë të shpërpjesëtuar nga pandemia e COVID-19. Gjithashtu, gjurmuesit e kontakteve janë nga lagjet e NYC më të goditurat nga COVID-19.

Përveç kësaj, përmes ortakërive me mbi dhjetëra organizata me bazë komunitare në të gjithë qytetin, NYC Test & Trace Corps po ofron Navigatorë Burimesh për t'i ndihmuar njujorkezët t'i kapërcejnë problemet logjistike që mund të hasin kur veçojnë në mënyrë të sigurt në shtëpitë e tyre ushqimin ose mjekimin.

Testimi

Kush mund të testohet?

Të gjithë njujorkezët mund të përfitojnë testim diagnostic të COVID-19 dhe testim për antitropa pa kosto. Të gjithë njujorkezët duhet të bëjnë testimin diagnostik kundër COVID-19, edhe nëse nuk kanë simptoma.

Ku mund të testohen njujorkezët?

Ka qindra pika testimi në të gjithë qytetin, duke përfshirë edhe mbi 30 qendra të NYC Health + Hospitals, në klinikat CityMD, pranë rezidencave NYCHA, në parqe dhe qendra argëtimi dhe përmes furgonëve të lëvizshëm të testimit. Për të gjetur një pikë testimi pranë jush, vizitoni nyc.gov/covidtest ose telefononi 212-COVID19 (212-268-4319).

A duhen të testohen njerëzit më shumë se një herë?

Po, të gjithë duhet të testohen shpesh për shëndetin dhe sigurinë e tyre dhe të dashurve të tyre.

A duhet të paguaj për testimin tim?

Jo, shumë pika testimi ofrojnë teste pa kosto për ju kundër COVID-19. Nuk ju duhet sigurim për të përfituar falas një testim kundër COVID-19 ose testim me antitrupa në çdo qendër të NYC Health + Hospitals. Nëse keni sigurim, është e rëndësishme të ndani informacionin tuaj të sigurimit në mënyrë që të mund të faturohet kompania e sigurimit. Megjithatë, nuk do t'ju duhet të paguani ndonjë gjë të përbashkët apo sigurim të përbashkët.

Kur dhe si do t'i marr rezultatet e testimit?

Rezultatet tuaja të testimit do të dalin brenda 3-5 ditëve. Ndërkohë që prisni rezultatet e testimit, është e rëndësishme që të veçoheni në mënyrë të sigurt në shtëpi ose në një hotel nëse keni simptoma të COVID-19 ose besoni se mund të jeni ekspozuar ndaj COVID-19.

Gjurmimi

Çfarë është gjurmimi?

Gjurmimi, i quajtur gjithashtu gjurmimi i kontaktit, përfshin gjetjen e personave që kanë rezultuar pozitiv ose janë ekspozuar ndaj COVID-19 dhe t'u kërkosh atyre të veçohen në mënyrë të sigurt nga personat e tjerë derisa të mos e përhapin më virusin.

Cili është roli i një gjurmuesi të kontakteve?

Gjurmuesit e kontakteve telefonojnë personat që rezultojnë pozitiv ose janë ekspozuar ndaj COVID-19. Gjurmuesi i kontakteve:

- + Do të pyesë si ndiheni
- + Do të pyesë nëse keni nevojë për shërbimet dhe mbështetjen për t'ju ndihmuar të qëndroni të shëndetshëm dhe të shmangni përhapjen e COVID-19
- + Do të sqarojë se sa duhet të qëndroni brenda dhe larg njerëzve të tjerë
- + Do të bëjë pyetje për të kuptuar si mund të jeni infektuar, nëse keni rezultuar pozitiv
- + Do të pyesë për emrat dhe informacionin e kontaktit të personave me të cilët keni pasur kontakt të ngushtë ndërkohë që mund ta keni përhapur virusin te të tjerët, nëse keni rezultuar pozitiv

Gjurmuesi i kontakteve mund t'ju vizitojë edhe vetë personalisht për të kontrolluar mirëqenien tuaj. Do t'ju tregojë kartën e tyre të identifikimit për të dëshmuar që është gjurmues kontaktesh.

Si e merr informacionin mbi personat NYC Test & Trace Corps?

Nëse ishit të diagnostikuar me COVID-19, NYC Test & Trace Corps e ka marrë informacionin tuaj nga Departamenti i Shëndetësisë të qytetit të Nju Jorkut. Ligji i shtetit të Nju Jorkut dhe Kodi Shëndetësor i qytetit të Nju Jorkut u kërkojnë laboratorëve t'i dërgojnë rezultatet pozitive të testimit te Departamenti Shëndetësor i qytetit të Nju Jorkut. Departamenti Shëndetësor i qytetit të Nju Jorkut e ka ndarë informacionin tuaj me NYC Test & Trace Corps në përputhje me ligjet e privatësisë që lejojnë përdorimin e këtij lloji informacioni për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të ndaluar përhapjen e sëmundjes.

Nëse jeni ekspozuar ndaj COVID-19, NYC Test & Trace Corps e ka marrë informacionin tuaj sepse dikush me COVID-19 i ka thënë gjurmuesit të kontakteve që keni qenë në kontakt të ngushtë me ta ose keni qenë në vendin ku dikush me COVID-19 mund t'ju ekspozuar edhe ju. Gjurmuesi i kontakteve nuk mund t'ju tregojë se kush i ka thënë që ju jeni kontakt i ngushtë.

Si mund ta dinë njujorkezët nëse personi që telefonon është gjurmues kontaktesh nga NYC Test & Trace Corps?

Gjurmuesit e kontakteve të NYC Test & Trace Corps po punojnë për të telefonuar çdokënd që ka rezultuar pozitiv me ose është ekspozuar ndaj virusit që shkakton COVID-19. Ju lutemi përgjigjuni në telefon nëse merrni një telefonatë nga:

- + NYC Test+Trace
- + NYC Covid Test
- + Numër telefoni që fillon me 212-540-XXXX ose 212-242-XXXX

Ju mund të pyesni edhe personin që ju telefonon t'ju jape një kod ta vendosni në mjetin "Validate My Tracer" (Verifiko Gjurmuesin Tim). Mjeti do të konfirmojë emrin e gjurmuesit të kontaktit nëse kodi është i vlefshëm. Pasi të jetë përdorur një kod i vlefshëm, ai skadon dhe nuk mund të përdoret sërish. Për të përdorur mjetin "Validate My Tracer":

- + 1) Kërkoni një kod nga personi që ju telefonon ose ju viziton.
- + 2) Vizitoni testandtrace.nyc.
- + 3) Zgjidhni "Click Here to Validate My Tracer" (Kliko këtu për të verifikuar gjurmuesin tim).
- + 4) Vendosni kodin.

Gjurmuesi i kontakteve KURRË:

- + Nuk do t'ju pyesë për emrin tuaj, sepse e di këtë gjë kur ju telefonon
- + Nuk do t'ju pyesë për numrin e sigurimeve shoqërore
- + Nuk do t'ju pyesë për informacione financiare private
- + Nuk do t'ju pyesë për informacione të kartës së kreditit
- + Nuk do t'ju pyesë për të marrë kontrollin ose për të shkarkuar program në telefonin, tabletin ose kompjuterin tuaj

Gjurmuesi i kontakteve mund t'ju vizitojë gjithashtu në shtëpi, veçanërisht nëse nuk mund t'ju arrijë përmes telefonit. Do t'ju tregojë kartën e tyre të identifikimit për të dëshmuar që është gjurmues kontaktesh.

Çfarë është "kontakti i ngushtë" me dikë që ka rezultuar pozitiv me COVID-19?

Kontakti i ngushtë përkufizohet si:

- + Të jetoni me dikë që ka rezultuar pozitiv me COVID-19
- + Të putheni ose të bëni seks me dikë që ka rezultuar pozitiv me COVID-19
- + Të ofroni përkujdesje në shtëpinë e dikujt që ka rezultuar pozitiv me COVID-19
- + Të kaloni 10 minuta ose më shumë brenda një distance prej 6 këmbë (2 metra) me dikë që ka rezultuar pozitiv me COVID-19

A mund të më thotë telefoni im inteligjent nëse kam pasur kontakt nga afër me dikë që ka pasur COVID-19?

Nëse shkarkoni dhe aktivizoni aplikacionin COVID Alert NY, do të merrni një paralajmërim nëse keni qenë në kontakt të afërt me dikë që ka testuar pozitiv për COVID-19. Aplikacioni nuk do të grumbullojë, transmetojë ose ruajë informacionin tuaj personal dhe është krejtësisht anonim. Vendndodhja juaj nuk do të gjurmohet kurrë; aplikacioni përdor teknologji Bluetooth për të kapur kur një person tjetër me të njëjtin aplikacion ndodhet 6 këmbë larg. Për më shumë informacion, vizitoni coronavirus.health.ny.gov/covid-alert-ny/.

Nëse kam COVID-19. Si t'u them kontakteve të mia të afërta se janë ekspozuar?

Gjurmuesit e kontaktit do t'i njoftojnë kontaktet tuaja të afërta se ata janë ekspozuar ndaj COVID-19 – por veëm nëse ju ndani emrat e tyre dhe informacionin e kontaktit me gjurmuesin tuaj të kontaktit. Gjurmuesi juaj i kontaktit nuk do t'i thotë kurrë kontakteve tuaja të afërta se jua jeni personi që ka dhënë emrat e tyre.

Ne rekomandojmë që ju t'i thoni kontakteve tuaja të afërta se ata janë ekspozuar ndaj COVID-19 përpara se t'i kontaktojë ata një gjurmues i kontaktit, nëse ndiheni rehat. Mund të thoni diçka të ngjashme me këtë: “Unë jam diagnostikuar me COVID-19. Për shkak se kemi qenë në kontakt të afërt ndërkohë që mund ta kem përhapur virusin, ju jeni ekspozuar ndaj tij. Duhet të qëndroni në shtëpi dhe larg nga personat e tjerë për 10 ditë që nga hera e fundit që keni qenë bashkë. Nëse nuk mund ta bëni këtë, telefononi linjën e telefonit NYC Test & Trace Corps në 212-COVID19 për informacion mbi burimet falas për të ndihmuar që të qëndroni të veçuar në mënyrë të sigurt, si për shembull ushqim falas dhe dhomë hoteli falas. Ju mund të telefononi edhe linjën telefonike ose të vizitoni nyc.gov/covidtest për të gjetur një vend testimi pranë jush.”

Përkujdesja

Çfarë lloj asistence do të përfitojnë njujorkezët kur izoloohen në shtëpi?

Të gjithë njujorkezët që veçohen në mënyrë të sigurt në shtëpi dhe monitorojnë gjendjen e tyre shëndetësore do të marrin telefonata apo mesazhe kontrolli ditor nga gjurmuesi i tyre i kontakteve, që mund dhe të kryejë vizita në vend për të kontrolluar mirëqenien e tyre. NYC Test & Trace Corps do të sigurojë gjithashtu vakte ushqimi dhe mjekime.

Si mund të marrin njujorkezët një dhomë hoteli falas për t'u siguruar në mënyrë të sigurt nëse kanë rezultuar pozitiv me COVID-19?

Mund të keni të drejtën e një qëndrimi falas në hotel deri 10 ditë, nëse nuk keni vend për t'u veçuar në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të dashurit tuaj. Për të mësuar më shumë, telefononi 212-COVID19 (212-268-4319).

Çfarë shërbimesh ofrohen në një hotel?

Njujorkezët që zgjedhin të veçohen në mënyrë të sigurt në një hotel do të kenë transport falas dhe mbështetje në çdo orë të ditës nga infermiere dhe personel i trajnuar klinik, vakte ushqimi falas, mundësi mbështetjeje për shëndetin mendor dhe mirëqenien, internet uajrles, televizion kabllor, si dhe telefonata të pakufizuara lokale për të ruajtur lidhjet me njerëzit e dashur. Testimi për COVID-19 është gjithashtu i disponueshëm në Take Care Hotels.

Si mundën ofruesit t'i referojnë pacientët në hotele?

Cilido mjek, infermiere apo asistent mjek në të gjithë qytetin mund të dërgojë email te CommCareCP@nychhc.org për të referuar një pacient në një dhomë hoteli. Nëse nuk keni mjek, mund të telefononi linjë direkte të NYC Test & Trace në numrin 212-COVID19 (212-268-4319), për të folur me dikë që mund t'ju ndihmojë të bëni një rezervim.

Për më shumë informacion rreth NYC Test & Trace, telefononi 212-COVID19 (212-268-4319) ose vizitoni testandtrace.nyc